



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 17 gusht 2020
Nr. ref.:RK 1602/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI121/19

Parashtrues

Ipko Telecommunications

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, ERev.nr.14/2019, i 30 prillit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ipko Telecommunications, e përfaqësuar nga shoqëria e avokatëve "Sejdiu & Qerkini" sh.p.k., (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin, ERev.nr.14/2019, të 30 prillit 2019, të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes të cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të parashtrueses të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt), të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale], të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 24 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 31 korrik 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 19 gusht 2019, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ta disa dokumente shtesë.
8. Në të njëjtën datë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 26 gusht 2019, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatë dokumentet e kërkuara.
10. Më 29 korrik 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 12 mars 2008, parashtruesi i kërkesës dhe pala e paditur, Dukagjini Telecommunications Sh.p.k., (në tekstin e mëtejme: Dukagjini Sh.p.k), kanë lidhur kontratë për ofrimin e shërbimeve mobile në rrjetin virtual. Këto

shërbime Dukagjini Sh.p.k., i ka shfrytëzuar në vazhdimësi dhe për to kishte paguar çmimin e dakorduar në mes të palëve. Sa i përket kësaj kontrate ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se borxh i përgjithshëm i Dukagjini Sh.p.k., ndaj parashtruesit të kërkesës, në emër të kontratës në fjalë, ishte 223,139.47 €.

12. Sipas shkresave të lëndës rezulton se, me 2 shtator 2008, parashtruesi i kërkesës i kishte bërë një ofertë Dukagjini Sh.p.k., për krijimin e infrastrukturës, sistemit dhe mirëmbajtjes së rrjetit virtual mobil, si dhe vendosjen dhe shfrytëzimin e softuerit. Këtë ofertë Dukagjini Sh.p.k., nuk e kishte pranuar shprehimisht dhe nuk i kishte paguar asnjë nga faturat e dërguara nga parashtruesi i kërkesës.
13. Më 28 janar 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti propozim mbi lejimin e përmbarimit të borxhit për shërbimet e ofruara telefonike, pranë Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Ekonomike), kundër Dukagjini Sh.p.k.
14. Më 2 shkurt 2011, Gjykata Ekonomike, përmes Aktvendimit E.nr.30/11, lejoi përmbarimin, duke detyruar debitorin, gjegjësisht Dukagjini Sh.p.k, për kthimin e borxhit në vlerën prej 1.853.268,88 €, me kamatë 3.5%, nga dita e arritjes së pagesës të secilës fature e deri në pagesën përfundimtare, për shfrytëzimin e shërbimeve mobile në rrjetin virtual, të operatorit virtual Mobil (MVNO).
15. Në një datë të pacaktuar, Dukagjini Sh.p.k, paraqiti kundërshtim ndaj Aktvendimit E.nr.30/11, të 2 shkurtit 2011 të Gjykatës Ekonomike, duke kontestuar posaçërisht pjesën e borxhit për start up (fillimin e punës) dhe pagesat mujore në shumën prej 44.000,00 €, për përdorimin e pajisjeve të IPKO-së. Dukagjini Sh.p.k., arsyetoi se nuk e kishte pranuar ofertën për infrastrukturën MVNO, për shkak të çmimeve shumë të larta.
16. Përmes parashtrësive të 21 shtatorit 2011, 10 majit 2012 dhe 31 majit 2012, pas dërgimit të faktuarave tjera deri në këto data, parashtruesi i kërkesës precizoi padinë e tij, me të cilën kërkoi që të detyrohet Dukagjini Sh.p.k që t'ia paguaj borxhin në shumë të përgjithshme prej 2.965.625.60 €. Në seancën dëgjimore të mbajtur më 8 qershor 2012, parashtruesi i kërkesës e korrigjoi një gabim teknik të parashtrësës së datës 31 maj 2012, ashtu që shumën e përgjithshme të borxhit për infrastrukturë e precizoi në 2.518.307,73 €.
17. Më 8 qershor 2012, Gjykata Ekonomike, përmes Aktgjykimit II.C.nr.37/2011, vendosi si në vijim: (i) shfuqizohet aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit E.nr.30/2011, i 2 shkurtit 2011, suprimohet ky aktvendim për pjesën e borxhit, kamatën dhe shpenzimet e përmbarimit, ndërsa propozimi i kreditorit për lejimin e përmbarimit konsiderohet padi, dhe (ii) aprovohet si e themeltë kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës (IPKO Telecommunications) dhe detyrohet i padituri, Dukagjini Telecommunications Sh.p.k., që paditësit t'ia paguaj borxhin në shumë prej 2.518.307,73 €, me kamatë sipas normës prej 3.5%, duke filluar nga 8 qershori 2012.

18. Në një datë të pacaktuar, i padituri, Dukagjini Sh.p.k., paraqiti ankesë pranë Gjykatës së Apelit, kundër Aktgjykimit C.nr.37/2011, të 8 qershorit 2011, të Gjykatës Ekonomike, për shkak të: (i) shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe (iii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i goditur të prishet dhe çështja të kthehet në rigjykim, apo që ky aktgjykim të ndryshohet dhe kërkesepadia e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar.
19. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti përgjigje në ankesë, me propozimin që ankesa e të paditurit (Dukagjini Sh.p.k.), të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.
20. Më 8 qershor 2015, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit Ae.nr.416/2012, aprovoi ankesën e të paditurit Dukagjini Sh.p.k. dhe prishi aktgjykimin e Gjykatës Ekonomike, C.nr.37/2011, të 8 qershorit 2012, duke urdhëruar që lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje pranë gjykatës së shkallës së parë.
21. Më 20 qershor 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), përmes Aktgjykimit I.C.nr.278/2015, vendosi që të: I. Miratoi pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, ku detyroi të paditurin Dukagjini Sh.p.k., që t'ia paguaj borxhin prej 223,139.47 euro, ndërsa II. Refuzoi pjesërisht si të pa bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës sa i përket shumës së kërkuar nga ai për ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës dhe krijimin e sistemit për mirëmbajtjen e rrjetit (vendosjes dhe shfrytëzimit të softuerit), në vlerë prej 2,366.675.60 euro.
22. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë pranë Gjykatës së Apelit, kundër Aktgjykimit C.nr.278/2015, të 20 qershorit 2016, të Gjykatës Themelore, për shkak të: (i) shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; (ii) konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe (iii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesi me ankesë kërkoi nga Gjykata e Apelit që të mirtohet kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës si e bazuar dhe të detyrohet i padituri, "Dukagjini Sh.p.k.", që në afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, në emër të borxhit kryesor, atij i'a paguaj shumën në lartësi prej 2,366.675.60€ dhe kamatën vjetore prej 3.5%, nga dita e paraqitjes së padisë e deri në realizimin e plotë të detyrimeve nga ky vendim.
23. Më 26 dhjetor 2018, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit Ae.nr.189/2016, refuzoi si të pa bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, I.C.nr.278/2015, të 20 qershorit 2016.
24. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ae.nr.189/2016, parashtruesi i kërkesës parashtrroi revizion në Gjykatën Supreme, me pretendimin për: (i) shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe (ii) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktgjykimet e të dy gjykatave të ndryshohen dhe të detyrohet i padituri (Dukagjini Sh.p.k.), që të paguaj borxhin paditësit në lartësi prej 2,366.678.60 €, me kamatë vjetore prej

3.5%, nga dita e paraqitjes së padisë deri në realizimin e plotë si dhe shpenzimet e procedurës.

25. Më 30 prill 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit ERev.nr.14/2019, refuzoi si të pabazuar revizionin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, kundër Aktgjykimit Ae.nr. 189/2016, të 26 dhjetorit 2018.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin ERev.nr.14/2019, të 30 prillit 2019, me pretendimin se është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt], të KEDNJ-së.
27. Përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi thekson se “është viktimë e një pa(drejtësie) e cila e vë atë në pozicion të pabarabartë para ligjit, duke i cenuar të drejtën e tij të pakontestueshme e që ka të bëjë me mosdhënien e arsytimit lidhur me vendosjen e të drejtës subjektive nga ana e Gjykatave të rregullta dhe zbatimin arbitrar të ligjit në raport me të drejtën e tij. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se Dukagjini Sh.p.k., i ka borxh edhe shumë prej 2,366,675.47 €, e cila buronte nga krijimi i infrastrukturës, sistemit dhe mirëmbajtjes së rrjetit virtual (vendosja e softuerit). Sipas parashtruesit, Dukagjini Sh.p.k., e ka pranuar ofertën me vet faktin e pranimit të të gjitha shërbimeve në ofertë. Në anën tjetër, Dukagjini Sh.p.k., thekson se që nuk e ka pranuar ofertën e lartpërmendur, pasi që shërbimet të cilat kanë qenë të precizuara në ofertë kanë qenë shërbime të ndërlidhura me kontratën e 12 marsit 2008, për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile.
28. Në këtë vazhde, parashtruesi i kërkesës pretendon se në rastin e tij Gjykata Supreme nuk i ka vlerësuar pretendimet e tij. Sipas parashtruesit të kërkesës, pretendimi kryesor i tij në të gjitha instancat gjyqësore ka qenë se “*e paditura e ka pranuar ofertën e paditësit me veprimet konkludente sepse i ka shfrytëzuar të gjitha shërbimet e parashikuara në ofertën e 02.09.2008*”. Ai thekson se Gjykata Supreme nuk ka treguar se çfarë efekti juridik kanë: “*shfrytëzimi i shërbimeve nga i padituri të përshkruara në ofertë dhe pranimi i borxhit nga drejtori financiar i të paditurës, se shërbimet e parashikuara në ofertë nuk janë të përfshira në kontratë*”.
29. Për të mbështetur pretendimet e tij, parashtruesi i kërkesës i referohet praktikës së Gjykatës Kushtetuese (rasteve: KI 72/12 , KI 35/14, KI 96/16), si dhe praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (më tutje: GJEDNJ), ku këto gjykata kanë gjetur shkelje të të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, për shkak të mos arsyetimit të vendimeve gjyqësore.
30. Sipas parashtruesit, në një situatë të ngjashme me rastet e lartcekura, Gjykata Supreme fare nuk ka dhënë ndonjë arsye për pretendimet kryesore të tij, por vetëm është pajtuar me gjetjet e Gjykatës së Apelit, duke mos vlerësuar fare pretendimet e parashtruesit, të paraqitura në revizion.

31. Në lidhje me këtë, parashtruesi thekson se *“nga Gjykata Supreme fare nuk janë trajtuar argumentet kryesore të parashtruesit se: a) – Shërbimet e parashikuara ne Oferte janë të ndryshme nga shërbimet te cilat janë përcaktuar me Kontratë ; b) - Shërbimet e përcaktuara ne Oferte janë duke u shfrytëzuar nga e paditura ; c) - Drejtori financiar i te paditurës përmes shkresës dërguar Parashtruesit të kësaj kërkesë i ka pranuar detyrimet që rrjedhin nga Oferta etj.”*
32. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se Gjykata Supreme mban një qëndrim kundërthënës në vendimin e saj, për arsye se: (i) nuk ka dhënë kurrfarë arsye se pse në rastin konkret nuk gjen zbatim neni 28 i LMD-së, i vitit 1978, sipas të cilit *“vullneti për lidhjen e kontratës mund të shprehet me fjalë, shenja të rëndomta ose me sjellje tjetër nga e cila me siguri mund të konstatohet se ky vullnet ekziston”*; po ashtu Gjykata Supreme nuk ka dhënë kurrfarë arsytimi se pse në rastin konkret nuk gjen zbatim neni 39.2 i LMD-së, sipas të cilit *“Oferta quhet e pranuar edhe kur i ofertuari e dërgon sendin ose e paguan çmimin, si dhe kur e ndërmerr ndonjë veprim, i cili në bazë të ofertës, praktikës së përcaktuar në mes të palëve të interesuara ose zakoneve, mund të konsiderohet si deklaram i pranimi të ofertës”*; dhe (ii) Gjykata Supreme në mënyrë arbitrare dhe pa dhënien e asnjë arsytimi ka konstatuar se paditësi nuk ka ofruar asnjë provë të bazuar në nenin e cekur, që argumenton faktin që e paditura e ka pranuar ofertën.
33. Më tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se nuk kërkohet deklarimi shprehimor i të ofertuarit për pranimin e ofertës. Po ashtu ai thekson se në bazë të ekspertizës vërtetohet fakti se *“e paditura me veprime konkludente e ka pranuar ofertën e cila ishte objekt kontesti në procedurën kontestimore”*.
34. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të aprovojë kërkesën e tij dhe të konstatoj se në këtë rast ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirive kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, dhe të shpallë të pavlefshëm Aktvendimin e Gjykatës Supreme, ERev.nr.14/2019, të 30 prillit 2019 dhe ta kthejë rastin në rivendosje.

Dispozitat relevante ligjore

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, 1978

Deklarimi i vullnetit

Neni 28

Vullneti për ta lidhur kontratën mund të deklarohet me fjalë, me shenjat e zakonshme ose me ndonjë sjellje tjetër nga e cila mund të konkludohet me siguri për ekzistimin e tij.

Deklarimi i vullnetit duhet të bëhet lirisht dhe seriozisht.

Pranimi i ofertës

Neni 39

Oferta quhet e pranuar kur ofertuesi e merrë deklaratën e të ofertuarit se e pranon ofertën.

Oferta quhet e pranuar edhe atëherë kur ofertuesi e dërgon sendin ose e paguan çmimin, si dhe kur bën ndonjë veprim tjetër i cili në bazë të ofertës, praktikës së vërtetuar midis palëve të interesuara dhe zakoneve, mund të konsiderohet si deklaratë mbi pranimin.

Pranimi mund të revokohet në qoftë se ofertuesi e merr deklaratën mbi revokimin përpara deklaratës mbi pranimet ose njëkohësisht me të.

Heshtja e të ofertuarit

Neni 42

Heshtja e të ofertuarit nuk do të thotë pranim i ofertës.

Nuk ka afekt dispozita në ofertë se me heshtje të të ofertuarit ose ndonjë ometim tjetër i tij (p.sh, në qoftë se nuk e refuzon ofertën brenda afatit të caktuar apo në qoftë se sendin e dërguar mbi të cilin i afrohet kontrata nuk e kthen brenda afatit të caktuar etj.) do të konsiderohet si pranim.

Mirëpo kur i ofertuari ndodhet në lidhje të vazhdueshme afariste me ofertuesin lidhur me mallin e caktuar konsiderohet se e ka pranuar ofertën që të bëjë me mallin e tillë në qoftë se nuk e ka refuzuar menjëherë ose brenda afatit që i është lënë.

Po kështu personi që i është ofruar e refuzon ofertën brenda afatit të caktuar apo në qoftë se sendin e dërguar mbi të cilin i afrohet kontrata nuk e kthen brenda afatit të caktuar etj.) do të konsiderohet si pranim.

Mirëpo kur i ofertuari ndodhet në lidhje të vazhdueshme afariste me ofertuesin lidhur me mallin e caktuar konsiderohet se e ka pranuar ofertën që të bëjë me mallin të tillë në qoftë se nuk e ka refuzuar menjëherë ose brenda afatit që i është lënë.

Po kështu personi që i është ofruar tjetrit që të zbatojë urdhërat e tij [për] kryerjen e punëve të caktuara, si dhe personi në veprimtarinë afariste të cilit hyn ushtrimi ka për detyrë ta zbatojë urdhërin e marrë në qoftë se nuk e ka refuzuar menjëherë.

Në qoftë se në rastin nga paragrafi paraprak, oferta respektivisht urdhëri nuk është refuzuar, konsiderohet se kontrata është lidhur në momentin kur oferta, respektivisht urdhëri i ka arritur të ofertuarit.

Pranueshmëria e kërkesës

35. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregulloren e punës.
36. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 21.4 [Parimet e Përgjithshme] dhe 113.1 dhe 113.7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

Neni 21

[...]

4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.

[...]

Neni 113

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

37. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtuesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

38. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në pajtim me nenin 21.4 të Kushtetutës, parashtuesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u referuar në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejnë për individët dhe personat juridikë (shih Gjykata Kushtetuese, rasti nr. KI41/09, parashtuesi i kërkesës *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14).
39. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve tjerë të përmendura më lart, Gjykata konstaton se parashtuesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin ERev.nr.14/2019 të 30 prillit 2019, të Gjykatës Supreme, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtuesi i kërkesës gjithashtu ka qartësuar të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
40. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Konkretisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

41. Në dritën e këtij sfondi normativ, Gjykata sjellë në vëmendje se, në rrethanat e rastit konkret, çështja thelbësore ndërlidhet me pretendimin për ekzistimin e një detyrimi kontraktues, gjegjësisht një borxhi, për të cilin parashtuesi i kërkesës pretendon se nuk i është paguar nga ana e palës së paditur, Dukagjini Sh.p.k. Parashtuesi i kërkesës pretendon se këtë borxh duhet t’ia paguaj Dukagjini Sh.p.k., për arsye se i njëjti buron nga oferta që parashtuesi i kërkesës ia ka bërë kompanisë Dukagjini Sh.p.k., përmes së cilës parashtuesi i kërkesës i kishte ofruar krijimin e infrastrukturës, sistemit dhe mirëmbajtjes së rrjetit virtual. Oferta në fjalë nuk ishte pranuar asnjëherë, shprehimisht, nga ana e kompanisë Dukagjini Sh.p.k. Lidhur me këtë, parashtuesi i kërkesës pretendon se kompania Dukagjini Sh.p.k., përmes veprimeve konkludente – konkretisht duke pranuar faturat dhe duke mos iu përgjigjur ofertës së parashtuesit të kërkesës, pra në heshtje – ka pranuar ofertën në fjalë dhe me këtë obligohet që ta paguaj borxhin në shumën prej 2,366.675.47€. Marrë parasysh këtë, parashtuesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka bërë interpretim të gabuar të ligjit, përkatësisht nenit 39.2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejshëm: LMD), për arsye se

“pikërisht ky nen përcakton mundësinë e lidhjes së kontratës me veprime konkludente dhe nuk kërkon deklarin shprehimor të të ofertuarit për pranimin e ofertës”.

42. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktvendimi i kontestuar i Gjykatës Supreme shkelë të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejt dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së, ku ai kryesisht thekson se Gjykata Supreme nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm vendimin e saj dhe ka bërë interpretime arbitrare ligjore.
43. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit, që lidhen me mos arsyetimin e vendimeve të gjykatave në rastin e tij, Gjykata thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë, por duke mos u kufizuar, në rastet: *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykimi i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykimi i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykimi i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykimi i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI97/16, parashtrues *“IKK Classic”*, Aktgjykimi i 9 janarit 2018; KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012; KI22/16, *Naser Husaj*, Aktgjykimi i 9 qershorit 2017; dhe KI143/16, *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018.
44. Në parim, praktika gjyqësore e GJENDJ-së dhe ajo e Gjykatës Kushtetuese theksojnë se e drejta për një proces të rregullt gjyqësor përfshin të drejtën për një vendim të arsyetuar dhe se gjykatat duhet *“të tregojnë me qartësi të mjaftueshme arsyet në të cilat ata bazuan vendimin e tyre”*. Megjithatë, ky detyrim i gjykatave nuk mund të kuptohet si kërkesë për një përgjigje të hollësishme në çdo argument. Shkalla në të cilën zbatohet obligimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të mbështetura në ligjin e aplikueshëm.
45. Në këtë drejtim, Gjykata do të shtjellojë nëse pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mungesë të një vendimi të arsyetuar gjyqësor, sa i përket Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, ERev.nr.14/2019, të 30 prillit 2019, janë në përputhshmëri me garancitë procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
46. Gjykata rikujton se në Aktgjykimin I.C.nr. 278/2015, të Gjykatës Themelore, lidhur me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se është krijuar raport

detyrimor në mes të palëve, bazuar në ofertën e 20 shtatorit 2008, Gjykata Themelore theksoi si në vijim: “Gjykata e ka pranuar si të saktë konstatimin e ekspertit të ART-së se nuk do të mund të realizohej implemtimi i kontratës së datës 12.03.2008, pa instalimin e softuerit në fjalë, ngase i njëjti ka qenë i nevojshëm për regjistrimin e thirrjeve dhe SMS-ve të ofruara nga i padituri për klientët e vet. Po ashtu, regjistrimi dhe faturimi i thirrjeve dhe SMS-ve, është bërë duke e përdorur softuerin në fjalë.”

47. Gjykata Themelore, lidhur me zbatimin e dispozitave të caktuara të LMD-së, përkatësisht nenit 39.1 dhe 39.2, arsyetoi se: “Në rastin konkret nuk janë përmbushë këto kritetere ligjore mbi pranimin e ofertës. I padituri nuk ka dhënë deklaratë shprehimore se e pranon ofertën dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që mund të bie në fushën e rregullimit ligjor nga neni 39.2 i LMD-së. Ai vetëm ka pranuar shërbime të cilat i ka konsideruar si pjesë e kontratës bazë. Rrjedhimisht, as heshtja e të paditurit nuk ka nënkuptuar pranim të ofertës. Madje, me asnjë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar detyrimi i të ofertuarit që në rast të heshtjes apo mospranimi të ofertës, të refuzoj mallin apo shërbimin që i është servuar.
48. Më tutje, në lidhje me me heshtjen e të ofertuarit, Gjykata Themelore konstatoi se: “Me nenin 40.3 të LMD-së, është përcaktuar se heshtja e të ofertuarit duhet nënkuptuar si pranim në heshtje i ofertës, vetëm në rastet kur në mes të ofertuesit dhe të ofertuarit ekzistojnë lidhje të përhershme afariste, lidhur me mallin e caktuar, në kuptim të kësaj dispozite konsiderohet se i ofertuari e ka pranuar ofertën që ka të bëjë me mallin e tillë në qoftë se nuk e ka refuzuar ofertën menjëherë ose brenda afatit të lënë. Në rastin konkret nuk janë përmbushë as kriteret e kësaj dispozite ligjore, ngase paditësi dhe i padituri nuk kanë qenë më parë në lidhje të përhershme afariste, në ofrimin e shërbimeve të Softverit. Pra, nuk bëhet fjalë për një vazhdimësi faktike të një raportit juridik të krijuar më parë.”
49. Gjykata vëren se edhe Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit Ae.nr.189/2016, të 26 dhjetorit 2018, gjithashtu e kishte trajtuar çështjen e ofertës dhe pranimi të saj, në kuadër të pretendimit për krijim të raportit juridik përmes ofertës së 20 shtatorit 2008, të bërë nga parashtruesi i kërkesës tek Dukagjini Sh.p.k., duke konstatuar si në vijim: “Kjo gjykatë [...] ka gjetur se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale sepse me Nenin 39.1 të LMD-së, është përcaktuar se: ‘Oferta quhet e pranuar kur ofertuesi e merre deklaratën e të ofertuarit se e pranon ofertën’. Ndërsa me Nenin 42. par 1 të LMD-së, përcaktohet se: ‘heshtja e të ofertuarit nuk do të thotë pranim i ofertës’. Nga dispozitat e cituara rrjedh se për tu konsideruar pranim i ofertës duhet të ekzistojë deklarata e të ofertuarit mbi pranimin e vullnetit dhe vullneti i shprehur qartë për lidhjen e kontratës nën kushtet e përcaktuara në ofertë. Në rastin konkret, nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton se palët kanë lidhur kontratën e datës 12.03.2008, dhe janë pajtuar për elementet esenciale të saj. Të dy palët si subjekte të specializuara i kanë pasur të qarta obligimet kontraktuese. Fakti i konstatuar nga eksperti se softueri është shfrytëzuar vetëm nga i padituri pasi që paditësi ka kaluar në një platformë tjetër, dhe softuerin nuk e shfrytëzon për nevoja të veta, por softueri shfrytëzohet vetëm për nevojat e të paditurit, nuk krijon detyrim për të paditurin sepse ai nuk mund të përcaktoje mënyrën e shfrytëzimit të softverit

nga ana e paditësit ndërsa në anën tjetër i njëjti ekspert ka konstatuar se, shërbimet e trafikut komunikues nuk do të mund të realizoheshin pa ofrirmin e shërbimeve të softuerit. Nga kjo rezulton se softveri i përdorur nga i padituri është përdorur për përmbushjen e shërbimeve të kontraktuara sepse shërbimet janë të ndërlidhura sepse shërbimet e trafikut nuk mund të shfrytëzohen pa ato të infrastrukturës.”

50. Gjithashtu, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit të lartpërmendur iu përgjigj edhe pretendimit ankimor se oferta u pranua përmes veprimeve konkludente, duke arsyetuar si në vijim: *“Pretendimin ankimor se oferta është pranuar me veprime konkludente, Gjykata e Apelit e vlerëson si të pabazuar sepse në bazë të Nenit 42.3 të LMD-së, kur i ofertuari ndodhet në lidhje të vazhdueshme afariste me ofertuesin lidhur me mallin e caktuar konsiderohet se e ka pranuar ofertën që të bëjë me mallin e tillë në qoftë se nuk e ka refuzuar menjëherë ose brenda afatit që i është lënë. Në rastin konkret nuk mund të aplikohet kjo dispozitë sepse ajo i referohet sasisë së mallrave e jo llojit apo cilësisë së shërbimeve të ofruara.*
51. Gjykata vëren se Gjykata Supreme e kishte refuzuar si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës dhe kishte vlerësuar se aktgjykimi i goditur i Gjykatës së Apelit nuk përmban të meta që kishin ndikuar në ligjshmërinë e saj lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe se gjykata e shkallës së dytë drejtë ka vlerësuar se nuk janë krijuar raportet detyrimore kontraktuese në mes palëve, nga oferta në bazë të dispozitave që i referohen ofertës.
52. Kështu, Gjykata Supreme, për sa i përket çështjes së pranimi të ofertës përmes veprimeve konkludente, ndër të tjera kishte theksuar si në vijim:

“Parashtrimet në revizion se i padituri me veprime konkludente ka pranuar ofertën dhe në këtë drejtim ka detyrim ta paguaj borxhin për shkak se i padituri me rregull janë prezantuar faturat dhe i njëjti nuk e ka kontestuar [...] nga kjo Gjykatë u vlerësuan si të pa bazuara. Kjo për faktin se heshtja e të paditurit nuk nënkuptohet si pranim i ofertës. Madje, me asnjë dispozitë ligjore nuk është përcaktuar detyrimi i të ofertuarit që në rast të heshtjes apo mospranimi të ofertës, të refuzojë apo mallin e shërbimit që i është servisuar. Qëndron fakti që të paditurit i kanë arritur faturat kontestuese për pagesën e shërbimeve sipas ofertës dhe se të njëjtat nuk janë kontestuar, por kjo rrethanë assesi nuk nënkupton si pranimi i ofertave në vështrim të nenit 39.2 të LMD-së, pasi që në rastin konkret nuk janë përmbushur kritere ligjore mbi pranimin e ofertës. I padituri nuk ka dhënë deklaratë shprehimore se e pranon ofertën dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim që mund të bie në fushën e rregullimit ligjor nga neni 39.2 të LMD-së ku është përcaktuar se oferta konsiderohet e pranuar edhe në rastin se i ofertuari e dërgon sendin, e paguan çmimin, apo ndërmerr ndonjë veprim tjetër që sipas praktikës së vërtetuar në mes të palëve apo zakoneve, do të mund të konsiderohej si pranim i ofertës, i padituri në këtë rast ka pranuar vetëm shërbime të cilat i ka konsideruar si pjesë e kontratës bazë”.

53. Për sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar se pse në rrethanat e rastit konkret nuk gjen zbatim neni 28 i

LMD-së, kjo Gjykatë i referohet Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, ku theksohet se:

Janë të pa bazuara parashtrimet në revizion, se nga gjykata e shkallës së dytë në mënyrë të gabuar është zbatuar dispozita e nenit 42.3 të LMD-së, pasi që paditesi gjithnjë i është referuar nenit 28 të LMD-së i cili përcakton mënyrën e shprehjes së vullnetit për lidhjen e kontratës. Kjo për faktin se me nenin 42.3 të LMD-së, është përcaktuar se heshtja e të ofertuarit duhet nënkuptuar si pranim në heshtje të ofertës vetëm në rastet kur në mes të ofertuesit dhe të ofertuarit ekzistojnë lidhje të përhershme afariste, lidhur me mallin e caktuar, në kuptim të kësaj dispozite konsiderohet se i ofertuari i ka pranuar ofertën që ka të bëjë me mallin e tillë në qoftë se nuk e ka refuzuar ofertën menjëherë ose brenda afatit të lënë. Në rastin konkret nuk mund të aplikohet kjo dispozitë për arsye se ajo dispozitë i referohet sasisë së mallrave e jo llojit apo cilësisë së shërbimeve të ofruara.

54. Për sa më sipër, Gjykata vë në pah se nenin 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk nënkupton një përgjigje të hollësishme për çdo argument të palëve (Shih rastet e GJEDNJ-së: *Van de Hurk kundër Hollandës*, kërkesa nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 Prillit 1994, paragrafi 61; *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], cituar më lartë, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, kërkesa nr. 40490/98, Vendim për paranueshmëri i 29 gushtit 2000; *Perez kundër Francës* [DHM], kërkesa nr. 47287/99, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81).
55. Ky qëndrim është mbajtur vazhdimisht nga Gjykata Kushtetuese, duke u mbështetur edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Në këtë vijë, Gjykata Kushtetuese në vazhdimësi ka theksuar se nuk është roli i Gjykatës Kushtetuese të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale (Shih rastet e Gjykatës KIO6/17, cituar më lart, paragrafi 38; KIO122/16, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KIO49/19, cituar më lart, paragrafi 49).
56. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se gjykatat kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për të ofruar një arsyetim të mjaftueshëm ligjor përkitazi me kërkesat dhe pretendimet e parashtruesit. Për rrjedhojë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës ka përfituar nga e drejta e tij për të pranuar vendime të arsyetuara gjyqësore, në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
57. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit se Gjykata Supreme ka bërë interpretime të gabuara ligjore, Gjykata rithekson se, në parim, çështje që ndërlidhen me konstatimin e fakteve në procedura gjyqësore dhe interpretimin e ligjeve, janë në jurisdiksionin e gjykatave të rregullta. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit ose të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmëria), përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin

- e saj. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastet e Gjykatës: KI198/18, me parashtrues *Osman Mazreku*, Aktvendim për Papranueshmëri i 18 shkurtit 2020, paragrafi 76; KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 6 qershorit 2018, paragrafi 57; KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; dhe KIO6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 37; shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së: *García Ruiz kundër Spanjës*, kërkesa nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28).
58. Megjithatë, Gjykata gjithashtu ka theksuar vazhdimisht që edhe pse roli i Gjykatës është i kufizuar në kuptimin e vlerësimit të interpretimit të ligjit, ajo duhet të sigurohet dhe të ndërmerr masa kur vëren se një gjykatë ka aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar në një rast të caktuar, i cili mund të ketë rezultuar në përfundime arbitrare (Shih gjithashtu, rastet e Gjykatës: KIO6/17, parashtrues *L. G. dhe pesë të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 tetorit 2016, paragrafi 40; dhe KI122/16, parashtrues *Riza Dembogaj*, Aktgjykim i 6 qershorit 2018, paragrafi 59. Shih poashtu rastet e GJEDNJ-së: *Anheuser-Busch Inc.*, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 83; *Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rosisë*, Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafët 70-74 dhe 84; *Păduraru kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 5 dhjetorit 2005, paragrafi 98; *Soutransauto Holding kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 25 korrikut 2002, paragrafët 79, 97 dhe 98; *Beyeler kundër Italisë* [GC], Aktgjykim i 5 janarit 2000, paragrafi 108; *Koshoglu kundër Bulgarisë*, Aktgjykim i 10 majit 2007, paragrafi 50).
59. Në dritën e interpretimeve dhe arsyetimeve që janë dhënë në vendimet e gjykatave të rregullta (të paraqitura më lartë), Gjykata konsideron se kërkesa nuk dëshmon se procedurat pranë Gjykatës Supreme dhe gjykatave të shkallës më të ulët kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të parashtruesit, të mbrojtura me Kushtetutë, janë shkelur si rrjedhojë e interpretimeve të gabuara ligjore.
60. Për më tepër, nga sa u tha më sipër, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të mjaftueshme që para gjykatave të rregullta t'i prezantojë të gjitha pretendimet për shkelje të të drejtave të tij. Argumentet e tij janë dëgjuar në mënyrë të rregullt dhe janë shqyrtuar në mënyrë të duhur nga gjykatat e rregullta, vendimet e gjykatave të rregullta janë të arsyetuara dhe procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, nuk kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (Shih *mutatis mutandis* rastet e Gjykatës: KI85/19, me parashtrues *Bujar Shabani*, Aktvendim për Papranueshmëri i 6 prillit 2020, paragrafi 78; KI24/19, me parashtrues *Valon Miftari*, Aktvendim për Papranueshmëri i 11 tetorit 2019, paragrafi 34; Shih gjithashtu rastin e GJEDNJ-së: *Shub kundër Lituanisë*, kërkesa nr. 17064/06, Aktgjykim i 30 qershorit 2009).
61. Në këtë drejtim, Gjykata e konsideron të nevojshme të vë theksin në qëndrimin parimor se “drejtësia” që garanton neni 31 i Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në terma praktik dhe në parim, kjo shprehet para së gjithash përmes garantimit të

një procedure kontradiktore, ku palët dëgjohen dhe vendosen në të njëjtat kushte para Gjykatës (Shih në këtë aspekt, rastet e Gjykatës nr. KI42/16 Parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2016, paragrafi 41 dhe referencat tjera të përmendura aty; dhe KI49/19, cituar më lart, paragrafi 55).

62. Gjykata gjithashtu rithekson se neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe as nuk përcaktojnë që Gjykata Kushtetuese të vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil (Shih rastet e Gjykatës KI118/17 parashtrues *Şani Kervan* dhe të tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 17 janarit 2018, paragrafi 36; KI49/19, cituar më lart, paragrafi 54; dhe KI99/19, parashtrues *Persa Raičević*, Aktvendim për Papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48).
63. Gjykata vë në pah se objekt i kontestit pranë gjykatave të rregullta ka qenë një raport kontraktues, gjegjësisht një borxh i pretenduar që Dukagjini Sh.p.k., i ka parashtruesit të kërkesës, Ipko Telecommunications. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se në procedurën pranë gjykatave të rregullta nuk është kontestuar që parashtruesi i kërkesës ka kryer shërbimet që ishin të përfshira në ofertën për të cilën gjykata e rregullta, në bazë të interpretimeve të tyre ligjore, kanë konstatuar se nuk ishte pranuar nga Dukagjini Sh.p.k. Në ndërlidhje me këtë, Gjykata dëshiron të potencojë se vendimi i saj kufizohet në vlerësimin e zbatimit të standardeve dhe garancive procedurale që ofron neni 31 i Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ. Rrjedhimisht, Gjykata dëshiron të potencojë se ky Aktvendim i saj nuk paragjykon ndonjë procedurë tjetër eventuale që mund të zhvillohet para gjykatave të rregullta, lidhur me të njëjtën çështje.
64. Prandaj, duke marrë parasysh rrethanat e rastit, pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij se procedurat pranë gjykatave të rregullta, në ndonjë mënyrë, ishin të padrejta apo arbitrare dhe se përmes Aktgjykimit të kontestuar janë shkelur të drejtat dhe liritë e garantuara me nenin 31 të Kushtetutë dhe me nenin 6 të KEDNJ.
65. Si përfundim, Gjykata konsideron se kërkesa, në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë.
66. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe shpallet e papranueshme, siç përcaktohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe specifikohet më tej me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 21.4, 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 29 korrik 2020, njëzëri

VENDOS


- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi